



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 518 Prot.

Tiranë, më 21.01.2025

URDHËR

Nr. 37, Datë 21.01.2025

“PËR

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË URDHËRIN NR. 100, DATË 25.2.2022 “PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN DHE ZHVILLIMIN E
PRAKTIKAVE PROFESIONALE NË PROFESIONIN E RREGULLUAR TË MËSUESIT”, I
NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 26 dhe 57, të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe urdhrit nr. 609, datë 20.12.2024 “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të arsimit dhe sportit, znj. Orjana Osmani”,

URDHËROJ:

1. Në rregulloren bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të urdhrit nr. 100, datë 25.2.2022, “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale në profesionin e rregulluar të mësuesit”, i ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:
 - a) Në shkronjën “c” të pikës 2 të nenit 4 fjalët “...të paktën një vit mësimor...” zëvendësohen me fjalët “...të paktën një periudhë 3 mujore...”.

b) Pas shkronjës “ç”, të nenit 6, shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje:
“d) Pas përfundimit me sukses të praktikës profesionale të çdo periudhe, AKAP përcjell në MAS raportin e praktikës profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit”.

c) Pikat 3 dhe 5 të nenit 14 ndryshojnë si vijon:

“3. Kandidati i interesuar për të zhvilluar praktikën profesionale plotëson në formular vetdeklarimin e gjendjes gjyqësore dhe ngarkon në platformën e-Albania dokumentet si më poshtë:

- a) diplomat në fushën e mësuesisë ose diploma të njëvlershme me to, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe listën e notave/suplementin për secilën diplomë;
- b) raportin mjeko-ligjor;
- c) shfuqizohet;

...

5. Kandidati i interesuar për të zhvilluar praktikën profesionale, dosja e të cilit nuk përmban dokumentet e detyrueshme për t’u ngarkuar në platformën e-Albania, nuk pranohet të marrë pjesë në zhvillimin e praktikës profesionale.”.

ç) Kudo në rregullore, fjalët: “Drejtoria e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar (DPAP)”, zëvendësohet me fjalët “Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (AKAP)”.

d) Pas nenit 22 shtohet neni 23 me përmbajtje si më poshtë:

“Neni 23
Dispozita kalimtare

Kërkesat dhe procedurat administrative, që janë në proces shqyrtimi nga ministria përgjegjëse për arsimin, trajtohen dhe zhvillohen sipas dispozitave në fuqi të këtij urdhri, në kohën e paraqitjes së tyre.”.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Ministria e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, drejtoritë

rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet e arsimit parauniversitar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSMINISTRI

ORJANA OSMANI

